



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-5554 /2024

Klinë, datë 22/02/2024

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare, nr.28/2008 me dt. 04.06.2008, nenit 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës të dt.07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh nevojat zyrtare, Kryetari i Komunës së Klinës, **mori**;

V E N D I M

Për autorizimin e nënshkrimit të kontratave

1. **AUTORIZOHET**, Agron Bacaj Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Klinës, qe të kryej veprimet e nevojshme procedurale përkatësisht nënshkrimin e kontratave për të punësuarit në sektorin e shëndetësisë.
2. I përmenduri autorizohet për nënshkrim të kontratave për të punësuarit në këtë sektor, i cili punën e vet e kryen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe i përgjigjet kryetarit të komunës.
3. Ky vendim për autorizim vlen deri ne tërheqjen eventuale të tij nga ana e autorizim dhënësit.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Të njoftohen:

- I përmenduri;
- QKMF, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj

